



MUAJI SHTATOR

1. † **E mërkurë. Fillimi i Vitit të Ri Kishtar.** Simeon Stiliti. Jisui i Naviut. Dhjakon Amuni dhe 40 dëshmoret me të (Athina, Antigoni, Aspasia, Adamantina, Afrodita, Diona, Elpiniqi, Erato, Efterpi, Hariklea, Izmini, Kaliroi, Kleonika, Kleopatra, Margarita, Marianthi, Melpomeni, Penelopa, Pandora, Ralia, Rubina, Thalia, Theano, Urania etj.). Dëshmorët Kalista, Evodi dhe Ermogjeni. Oshënar Meleti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i Fillimit të Vitit të Ri Kishtar (1 Tim. 2:1-7).

UNGJILLI i Fillimit të Vitit të Ri Kishtar (kërkoje të enjten e javës së parë të Llukait – Llk. 4:16-22).

2. **E enjte.** Dëshmor Mamai. Oshënar Joan Kreshmuesi. Eleazari dhe Finesi, të Drejtë .

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 11-të të Letrave (2 Kor. 4:1-12).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 11-të të Mattheut (Mtth. 24:13-28).

- 3. E premte.** Hierodëshor Anthimi i Nikomedisë. Fivia, dhjakoneshë. Oshënar Theoktisti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 11-të të Letrave (2 Kor. 4:13-18).

UNGJILLI i së premtes së javës së 11-të të Mattheut (Mtth. 24:27-33, 42-51).

- 4. † E shtunë.** Profeti Moisi. Hermiona, e bija e apostull Filipit. Hierodëshmor Vavila. Shën Petroni.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 11-të të Letrave (1 Kor. 1:3-9).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 11-të të Mattheut (Mtth. 19:3-12).

- 5. † E DIEL. XI MATTHEUT (Shërbëtori i pamëshirshëm).** Zaharia i drejtë, i ati i Joan Pagëzorit. Hierodëshmor Abdai në Persi. Dëshmor Medimni.

Tingulli II. Ungjilli mëngjesor ngjallësor XI

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 7 Vargëzimet ngjallësore, që bëhen 8. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. II: “Shkoi hija e ligjit...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe PARAVARGU i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve: “O çudi e re përmbi gjithë çuditë...”.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Kur zbritë te vdekja...”. “Lavdi...”, e profetit: “I stolisur priftërisht...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Misteri i fshehur...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET ngjallësore, sipas radhës, por në vend të Hyjlindësores së stikologjisë (grupit) së parë, thuhet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Të gjitha përmbi mendim...”.

BEKIMTORET ngjallësore, SHKALLESAT, DËGJIMI DHE PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA, SHTËPIA e tingullit. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një Kryq vijosi me shkop...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor XI.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe Zbritësorja IX: “Parajsë mistike je...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore XI dhe Hyjlindësorja e saj.

LAVDËRIMET: psalen 8 Vargëzimet ngjallësore. “Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore XI. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Kur zbritte te vdekja...”, e profetit: “I stolitur priftërisht...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Joakimi dhe Ana...”.

APOSTULLI i së dielës së javës së 11-të të Letrave (1 Kor. 9:2-12).

UNGJILLI i së dielës së javës së 11-të të Mattheut (Mtth. 18:23-35).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

6. E hënë. Mrekullia e Kryeengjellit Mihail në Hone. Dëshmore Kalodhota. Dëshmor Romuli.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i kryeengjellit (8 nëntor - Heb. 2:2-10).

UNGJILLI i kryeengjellit (8 nëntor - Llk. 10:16-21).

7. E martë. *Parakremtja e Lindjes së Hyjlindëses.* Apostujt Evodi, Onisifori, nga të 70-t. Dëshmor Sozoni. Kasiania, himnografe. Oshënar Daniel Katunakioti.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 12-të të Letrave (2 Kor. 5:15-21).

UNGJILLI i së martës së javës së 12-të të Mattheut (Mk. 1:16-22).

8. † E mërkurë. LINDJA E ZONJËS SONË TË TËRËSHENJTË DHE HYJLINDËSES MARI. Dëshmorët Seviri, Artemidori.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 6 (thuhet të tria nga 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Gjen. 28:10-17; **Leximi II:** Ezek. 43:27-44:4; **Leximi III:** Fja. Urt. 9:1-11).

PASVARGJET e së kremtes. “Lavdi...”, “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Krishti, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Nënës së tij të pacenuar, lindjen e së cilës kremtojmë sot, me fuqinë e Kryqit...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes (Llk. 1:39-49, 56).

Pas Ungjillit lexohet PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET e Kryqit: “Një kryq vijosi me shkop...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse, parajsë mistike je...”.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet dy herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

DHOKSOLOGJIA e Madhe dhe Përlëshorja e së kremtes (1 herë).

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *o i çuditshëm ndër shenjtorët*, ne që të psalim: Aliluia”.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

APOSTULLI i së kremtes (Filip. 2:5-11).

UNGJILLI i së kremtes (Llk. 10:38-42, 11:27-28).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes.

KUNGATORJA e së kremtes: “Kupë shpëtimi...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

- 9. † E enjte.** Mbledhja adhuruese në nderim të Hyj-prindërve të Drejtë Joakim dhe Ana. Kujtimi i Etërve të Sinodit III Ekumenik. Omari i Teruanit.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i shenjtorëve (Gal. 4:22-27).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 12-të të Mattheut (Mk. 1:29-35).

- 10. E premte.** Apostujt Apeli, Klementi, Luka, nga të 70-t. Dëshmoret Minodhora, Mitrodhora e Nimfodhora.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së premtes së javës së 12-të të Letrave (2 Kor. 7:10-16).

UNGJILLI i së parakremtes (Jn. 3:16-21).

- 11. † E SHTUNË.** *Para Lartësimit të Kryqit të Nderuar.* Oshënare Theodhora në Aleksandri. Oshënar Efrosin Kuzhinieri. Dëshmore Evanthia.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës para Lartësimit të Kryqit (1 Kor. 2:6-9).

UNGJILLI i së shtunës para Lartësimit të Kryqit (Mtth. 10:37-11:1).

12. † E DIEL. PARA LARTËSIMIT TË KRYQIT TË NDERUAR. *Mbyllja e Lindjes së Hyjlindëses.* Hierodëshmor Autonomi, Kornuti. Dëshmor Juliani, Tatjani.

Tingulli III. Ungjilli mëngjesor ngjallësor I.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, që bëhen 4. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, hyjlindësorja dogmatike e Ting. III: “Si të mos admirojmë lindjen tënde...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Le të dëfrenjë qielloret...”. “Lavdi dhe “Tani...”, e së kremtes.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Le të dëfrenjë...”. “Lavdi...”, po ajo: “Le të dëfrenjë...”. “Tani...”, e së kremtes.

NDENJËSORET: dy stikologjitë (grupet) e Ndenjësoreve ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie, psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. **DËGJIMI**, **SHKALLESAT** dhe **PARAVARGU** i tingullit.

SHKURTORJA (ngjallësore dhe e së kremtes) dhe **SHTËPIA** (ngjallësore dhe e së kremtes). **SINAKSARI** i ditës.

ZBRITËSORET: “Një Kryq vijosi me shkop...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor I.

Pas Ungjillit, lexohet “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmi 50, thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund **Zbritësorja IX**: “O Hyjlindëse, parajsë mistike...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore I dhe e së kremtes.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4.

“LAVDI...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore I. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes, por te refreni i dytë thuhet: “Shpëtona... që u ngjalle së vdekurish...”.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish...*”

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Le të dëfrejnë...”, e së kremtes dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “Joakimi dhe Ana...”.

APOSTULLI i së dielës para Lartësimit të Kryqit (Gal. 6:11-18).

UNGJILLI i së dielës para Lartësimit të Kryqit (Jn. 3:13-17).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdërojeni...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

13. E hënë. *Parakremtja e Lartësimit të Kryqit të Nderuar.* Kujtimi i përrurimit të Kishës së Ngjalljes në Jerusalem. Kornil Kryeqindësi. Dëshmor Aristidhi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i Përrurimit të Kishës (kërkoje më 13 shtator – Heb. 3:1-4).

UNGJILLI i Përrurimit të Kishës (kërkoje më 29 qershor – Mth. 16:13-19).

14. † E MARTË. LARTËSIMI I PËRBTOSHËM I KRYQIT TË NDERUAR (STAVROS). Kujtimi i Etërve të Sinodit VI Ekumenik.

Kreshmë

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 6. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, paravargu i ditës dhe leximet biblike (**Leximi I:** Eks. 15:22-:1; **Leximi II:** Fja. Urt. 3:11-18; **Leximi III:** Isa. 60:11-16).

PASVARGJET e vetëmelodishme të së kremtes. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA e së kremtes (3 herë).

PËRLËSHIMI: “Ai që u ngjall prej së vdekurish, Krishti, Perëndia ynë... me fuqinë e Kryqit të Nderuar dhe Jetëdhënës, lartësimin e të cilit kremtojmë sot, me mbrojtjen...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja e së kremtes (3 herë).

NDENJËSORET e së kremtes. SHKALLESAT: “Që prej rinisë sime...” dhe PARAVARGU i së kremtes.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor i së kremtes.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe PSALMI 50. Dhe më pas thuhet: “Lavdi...”, “Të gjithnjë na mbron...”. “Tani...”, po ajo: “Të gjithnjë na mbron...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, tropari i vetëmelodishëm i së kremtes: “O Kryq i Krishtit...” (në Kremtore). Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një kryq vijosi me shkop...”.

MADHËSHTIMET: Pas Këngës VIII thuhet thirrja: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...” dhe, në vend të: “Më të nderuarën...”, psalet Kënga IX e të dy kanoneve dhe në fund thuhet dy irmoset e Këngës IX: “O Hyjlindëse, parajsë mistike je...” dhe: “Mallkim’ i vjetër i stërgjyshit...”.

DËRGIMSORJA e së kremtes (3 herë).

LAVDËRIMET: psalen 3 Vargëzimet e përshembullta të së kremtes, të cilat bëhen 4 (e para thuhet 2 herë). “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

DHOKSOLOGJIA e Madhe (në Ting. IV). Në fund të Dhoksologjisë kryhet shërbesa e Lartësimit të Kryqit.

SHËRBESA E LARTËSIMIT TË KRYQIT

Litania. Në fund të Dhoksologjisë, koret, pasi shkojnë përpara derës veriore të Shenjtërores, fillojnë të psalin: “Shenjt Perëndi...”, ndërsa prifti që ndodhet para Tryezës së shenjtë, pasi temjanis dhiskun e stolitur me lule dhe me borzilok që ndodhet mbi Tryezën e shenjtë, mbi të cilin është vendosur Kryqi i nderuar, e ngre dhiskun, e vendos atë mbi kokë dhe, duke kaluar rreth e qark Tryezës së shenjtë, nga e djathta në të majtë, del nga dera veriore e Shenjtërores, shkon deri në fund të kishës dhe vjen sërish në mes të kishës, para Derës së Bukur të Shenjtërores. Përpara priftit që mban mbi krye Kryqin e nderuar, ecin djemtë që mbajnë në duar llambadhet dhe gjashtëkrahëshet, kori i psaltëve, të cilët psalin: “Shenjt Perëndi...” deri në fund të litanisë, si dhe dhjakonët që temjanisin Kryqin e nderuar.

Lartësimi I: Prifti e sjell Kryqin në mes të kishës, zakonisht te solea, dhe vjen rreth e qark tryezës së

stolisur që ndodhet atje. Më pas, qëndron përpara tryezës, i kthyer me fytyrë nga ikonostasi dhe, duke lartësuar Kryqin, thotë: “Urtësi. Drejt.”. Dhe e vendos Kryqin mbi tryezë. Në vazhdim, prifti temjanis Kryqin nga të gjitha anët duke psalur: “O Zot, shpëtoje popullin tënd...”, të cilën e përsërisin edhe koret.

Falja I: Më pas, pasi të ketë bërë tri metani, merr në dorë Kryqin dhe degë borziloku, qëndron me fytyrë nga ikonostasi dhe thotë: “*Mëshirona, o Perëndi, sipas mëshirës sate të madhe, të lutemi, dëgjo dhe mëshiro*”. Kori psal “Mëshiro, o Zot” (100 herë), ndërsa prifti, bën 3 herë shenjën e Kryqit me Kryqin që ka në dorë, përkulet pothuajse deri në tokë dhe ngrihet sërish ngadalë, derisa kori të thotë 100 herë “Mëshiro, o Zot”.

Falja II: Në vazhdim, shkon në anën jugore të tryezës, me fytyrë nga veriu, lartëson Kryqin e nderuar dhe thotë: “*Për Republikën e Shqipërisë, Presidentin, Qeverinë, ushtrinë dhe gjithë popullin, le t'i lutemi Zotit*”. Kori psal “Mëshiro, o Zot” (100 herë), ndërsa prifti bën lartësimin e dytë të kryqit, njëlloj si herën e parë.

Falja III: Në vazhdim, prifti shkon në anën lindore të tryezës, me fytyrë nga perëndimi, lartëson Kryqin e nderuar dhe thotë: “*Lutemi për Kryepiskopin tonë (aksh) dhe për tërë vëllazërinë tonë në Krishtin*”. Kori psal “Mëshiro, o Zot” (100 herë), ndërsa prifti bën lartësimin e tretë të Kryqit, njëlloj si herën e parë.

Falja IV: Më pas, prifti shkon në anën veriore të tryezës, me fytyrë nga jugu, lartëson Kryqin e nderuar dhe thotë: “*Lutemi edhe për mëshirë, jetë, paqe,*

shëndet, shpëtim, vështrim, ndjesë dhe falje të mëkateve të shërbëtorëve të Perëndisë, të enoritëve, epitropëve dhe ndihmëtarëve të kësaj shtëpie të shenjtë, bashkë me gratë dhe fëmijët e tyre". Kori psal: "Mëshiro, o Zot" (100 herë), ndërsa prifti bën lartësimin e katërt të Kryqit, njëlloj si herën e parë.

Falja V: Së fundmi, prifti shkon sërish para tryezës, me fytyrë nga lindja, lartëson Kryqin e nderuar dhe thotë: "*Lutemi edhe për çdo shpirt të të krishterëve orthodhoksë, për shëndet, shpëtim dhe faljen e mëkateve të tyre*". Kori psal: "Mëshiro, o Zot" (100 herë), ndërsa prifti bën lartësimin e pestë të Kryqit, njëlloj si herën e parë.

Lartësimi kryesor: Pas këtyre, bëhet Lartësimi kryesor. Prifti qëndron përpara tryezës, me fytyrë nga lindja, lartëson Kryqin e nderuar dhe bekon besimtarët, së pari nga lindja, më pas nga veriu, nga perëndimi dhe në fund nga jugu, duke psalur Shkurtoren: "Ti që mbi kryqin...". Më pas, e vendos Kryqin mbi dhisk dhe i falet, duke psalur: "Kryqit tënd i falemi, o Zot..." 1 herë dhe kori 2 herë të tjera. Në vazhdim, besimtarët vijnë të nderojnë Kryqin, ndërsa kori psal troparet: "Kryqi po ngrihet sot..." (në Kremtore). Pasi të gjithë besimtarët t'i jenë falur Kryqit, psalet Përlëshorja: "O Zot, shpëtoje popullin tënd..." dhe fillon Liturgjia Hyjnore.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes.

HYRTORJA e së kremtes: "*Lartësoni Zotin, Perëndinë tonë, dhe faljuni nënkëmbëses së këmbëve të tij, se është*

i shenjtë. Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, që u kryqëzove trupërisht, ne që të psalim: Alilua!

Pas HYRJES psalet Përlëshorja dhe Shkurtorja e së kremtes.

Në vend të “SHENJT PERËNDI...”, psalet: “Kryqit tënd...”.

APOSTULLI i së kremtes (1 Kor. 1:18-24).

UNGJILLI i së kremtes (Jn. 19:6-11, 13-20, 25-28, 30-35).

Tek “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet Madhështimi i së kremtes: “O Hyj lindëse, parajsë mistike je...”.

KUNGATORJA e së kremtes: “U shënuar mbi të drita e lavdisë...”.

Në vend të “PAMË DRITËN...”, psalet Përlëshorja e së kremtes.

“Emri i Zotit...” dhe Përlëshimi si në Mbrëmësore.

Shënime: *Nga nesër, deri më 20 shtator, në Liturgji, thuhet kanonet së kremtes, por me Hyrtoren: “Ejani t’i falemi.... Shpëtona... që u kryqëzove trupërisht...”. Shkurtorja: “Të që mbi Kryqin...”.*

15. E mërkurë. Dëshmor i madh Nikita Goti. Visarioni i Larisë. Josifi i Timishoarës. Dëshmor Porfir Aktori.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 13-të të Letrave (2 Kor. 9:12-10:7).

UNGJILLI i së mërkurës së javës 13-të të Mattheut (Mk. 3:20-27).

16. E enjte. Dëshmore e madhe Efimia. Dëshmore Melitina. Ludmilla, mbretëreshë në Çeki.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 13-të të Letrave (Kor. 10:7-18).

UNGJILLI i së enjtes së javës 13-të të Mattheut (Mk. 3:28-35).

17. † E premte. Dëshmore Sofia dhe të bijat: Besa, Shpresa, Dashuria. Dëshmore Agathoklia. Episkop Iraklidhi.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së premtes së javës së 13-të të Letrave (2 Kor. 11:5-21).

UNGJILLI i së premtes së javës së 13-të të Mattheut (Mk. 4:1-9).

18. † E SHTUNË. *Pas Lartësimit të Kryqit të Nderuar.* Evmeni i Kretës. Dëshmore Ariadhni. Oshënar Romili në Ravanicë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës pas Lartësimit të Kryqit (kërkoje të shtunën e javës së 12-të Letrave - 1 Kor. 1:26-2:5).

UNGJILLI i së shtunës pas Lartësimit të Kryqit (kërkoje të premtën e javës së 4-t të Joanit – Jn. 8:21-30).

**19. † E DIEL. PAS LARTËSIMIT TË KRYQIT TË
NDERUAR.** Dëshmorët Trofimi, Sebati dhe Dorimedi.
Dëshmorët Feliksi dhe Konstantia, në Napoli.

Tingulli IV. Ungjilli mëngjesor ngjallësor II.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 6 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, që bëhen 4. “Lavdi...”, e së kremtes. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. IV: “Profeti David...”.

HYRJA me temjanicë, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...” dhe paravargu i ditës.

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...” dhe “Tani...”, e së kremtes.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”. “Lavdi dhe “Tani...”, e së kremtes: “O Zot, shpëtoje popullin...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, psalet Përlëshorja ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”. “Lavdi...”, po ajo: “Lëçitjen gazmore...”. “Tani...”, e së kremtes: “O Zot, shpëtoje popullin...”.

NDENJËSORET: dy stikologjitë (grupet) e Ndenjëso-reve ngjallësore, por në vend të Hyjlindësoreve të çdo stikologjie (grupi), psalen Ndenjësoret e së kremtes.

BEKIMTORET ngjallësore. DËGJIMI, SHKALLESAT dhe PARAVARGU i tingullit.

SHKURTORJA dhe SHTËPIA ngjallësore. SINAKSARI i ditës.

ZBRITËSORET: “Një Kryq vijosi me shkop...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe UNGJILLI mëngjesor ngjallësor II.

Pas Ungjillit, lexohet “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet PSALMI 50. Pas Psalmi 50, thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...”. “Tani...”, “Me ndërmjetimet e Hyjlindëses...”. “Përdëllyes, përdëllemë...”, “Kur u ngrit Jisui...”. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe në fund Zbritësorja IX: “O Hyjlindëse, parajsë mistike...”.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore II dhe e së kremtes.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzime ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e së kremtes, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, Lavdia mëngjesore ngjallësore II. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së kremtes, bashkë me refrenet e tyre.

HYRTORJA: “Ejani t’i falemi... Shpëtona, o i Biri i Perëndisë, *që u ngjalle së vdekurish...*”

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Lëçitjen gazmore...”, e së kremtes: “O Zot, shpëtoje popullin...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja e së kremtes: “Ti që mbi Kryqin...”.

APOSTULLI i së dielës pas Lartësimit të Kryqit (kërkoje të dielën e javës së 21-të të Letrave - Gal. 2:16-20).

UNGJILLI i së dielës pas Lartësimit të Kryqit (kërkoje të dielën e javës 3 të Kreshmës - Mk. 8:34-9:1).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdërojeni...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

20. E hënë. Dëshmor i madh Efstathi me familjen e tij. Efstathi i Selanikut. Oshënar dëshmor i ri Ilarioni. Oshënar Olegu, princ.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 14-të të Letrave (2 Kor. 12:10-19).

UNJILLI i së hënës së javës së 1-rë të Llukait (Llk. 3:19-22).

21. E martë. *Mbyllja e Lartësimit të Kryqit të Nderuar.* Profeti Jona. Apostull Kodrati, nga të 70-t. Dëshmor Eusebi.

Shënim: *Duke qenë se sot mbyllet e kremtja e Lartësimit të Kryqit të Nderuar, shërbesa e shën Kodratit psalet në datën 22, bashkë me shërbesën e dëshmorit Foka.*

Shërbesa e mbylljes së Lartësimit të Kryqit të Nderuar psalet njëllj si ditën kryesore të së kremtes, domethënë njëllj si në datën 14 shtator, por me këto ndryshime: Në Mbrëmësore, nuk thuhet LEXIMET BIBLIKE nga Dhiata e Vjetër. PËRLËSHIMI nuk bëhet me frazën “Ai që u ngjall...”, siç bëhet në datën 14, sepse në Mëngjesoren e datës 21 nuk do të lexohet tropari: “Ne që pamë Ngjalljen e Krishtit...”.

Në Mëngjesore, nuk thuhet POLIELEI dhe, si rrjedhim, nuk psalet NDENJËSORJA e Stikologjisë (grupit) të tretë, por vetëm Ndenjësoret e dy stikologjive (grupeve) të para. Gjithashtu, nuk thuhet as UNGJILLI MËNGJESOR i së kremtes, por menjëherë pas Ndenjësoreve lexohet Psalmi 50. Menjëherë pas Psalmi 50, thuhet SHKURTORJA dhe SHTËPIA e së kremtes, si dhe SINAKSARI i ditës (i datës 21, jo i datës 14). Më pas thuhet ZBRITËSORET E KRYQIT dhe pjesa e mbetur e Mëngjesores. Pas Dhoksologjisë së Madhe, NUK KRYHET SHËRBESA E LARTËSIMIT TË KRYQIT TË NDERUAR.

Nëse do të kryhet Liturgji, psalen ANDIFONET, HYRTORJA, PËRLËSHORJA dhe SHKURTORJA e së kremtes. Thuhet Himni trishenjtor. Paravargu dhe Aliluari i së kremtes. APOSTULLI i së martës së javës së 14-të të Letrave (2 Kor. 12:20-13:2) dhe UNGJILLI i së martës së javës së 1-rë të Llukait (Llk. 3:23-4:1). Dhe vazhdon pjesa e mbetur e Liturgjisë, por te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, thuhet irmosi: “Mallkimi i drurit të Kryqit...”.

Shënime: Nga sot deri më 20 nëntor psalen Zbritësoret: “Ja gojën e çel tani...”. Në Liturgji, psalet Shkurtorja: “Mbrotje e paturpëruar...”.

22. E mërkurë. Hierodëshmor Fokai. Dëshmor Foka Kopshtari. Dëshmoret Dinja dhe Emerita, në Romë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 14-të të Letrave (2 Kor. 13:3-13).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 1-rë të Llukait. (Llk. 4:1-15).

23. † E enjte. Ngjizja e Joan Pagëzorit. Oshënaret Ksanthipi dhe Polikseni, në Spanjë.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i Pararendësit (Gal. 4:22-27).

UNGJILLI i Pararendësit (Llk. 1:5-25).

24. E premte. Thekla, dëshmorja e parë. Oshënar Siluan Athoniti. Shën Persida.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i dëshmores së madhe (kërkoje të dielën e javës së 32-të të Letrave - 2 Tím. 3:10-15).

UNGJILLI i së premtes së javës së 1-rë të Llukait (Llk. 4:22-30).

25. † E shtunë. Oshënares Efosina dhe Pafnuti, i ati. Oshënar Sergji në Radonezh.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

Liturgjia Hyjnore

APOSTULLI i së shtunës së javës së 14-të të Letrave (1 Kor. 4:1-5).

UNGJILLI i së shtunës së javës së 1-rë të Llukait (Llk. 4:31-36).

26. † E DIEL. XIV. JETËNDËRRIMI I APOSTULLIT DHE UNGJILLORIT JOAN THEOLOGU. Gedeoni i Drejtë. Oshënar Nili në Kalabri.

Tingulli Tërthor I. Ungjilli mëngjesor ngjallësor III.

Në Mbrëmësore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “O ZOT, THIRRA...” psalen 4 Vargëzimet ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshebullta të shenjtit, të cilat bëhen 6 (thuhet nga 2 herë). “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja dogmatike e Ting. Tërth. I: “Në detin e kuq...”.

HYRJA, “O Jisu Krisht, dritë gazmore...”, PARAVARGU i ditës dhe LEXIMET biblike (**Leximi I:** 1 Jn. 3:21-4:6; **Leximi II:** 1 Jn. 4:11-16; **Leximi III:** 3 Jn. 4:20-5:5).

PASVARGJET ngjallësore. “Lavdi...”, e shenjtit. “Tani...”, Hyjlindësorja e Pasvargjeve të tingullit, por në të njëjtin tingull me Lavdinë e Pasvargjeve të shenjtit.

PËRLËSHORJA ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”. “Lavdi...”, e shenjtit: “O apostull i dashur...”. “Tani...”, Hyjlindësorja: “Të gjitha përmbi mendim...”.

Në Mëngjesore:

Shërbesa kryhet si zakonisht.

Pas “PERËNDI ËSHTË ZOTI...”, Përlëshoret psalen si në Mbrëmësore.

NDENJËSORET. Dy stikologjitë e para ngjallësore, sipas radhës, por në vend të Hyjlindësorese së stikologjisë (grupit) së parë, thuhet Hyjlindësorja e Përlëshoreve: “Gëzohu, derë e Zotit...”. Si stikologji e tretë thuhet Ndenjësoret e shenjtorit: “I shenjti apostull...”. “Lavdi...” “Apostullin Joan le ta lavdërojmë sot...”. “Tani...” “Virgjëreshë dhe Nënë, Mari Hyjlindëse...”.

BEKIMTORET ngjallësore, **SHKALLESAT**, **DËGJIMI DHE PARAVARGU** i tingullit.

SHKURTORJA (ngjallësore dhe e shenjtorit) dhe **SHTËPIA** (ngjallësore dhe e shenjtorit). **SINAKSARI** i ditës.

ZBRITËSORET: “Ja gojën e çel tani...”.

“Le t’i lutemi Zotit...”, “Çdo frymë...” dhe **UNGJILLI** mëngjesor ngjallësor III.

Pas Ungjillit lexohet: “Ne që pamë Ngjalljen...” dhe psalet **PSALMI 50**. Pas Psalmi 50 thuhet: “Lavdi...”, “Me ndërmjetimet e Apostujve...” etj. Më pas thuhet: “O Perëndi, shpëtoje popullin tënd...”.

MADHËSHTIMET: pas thirrjes: “Hyjlindësen dhe Mëmën e Dritës...”, psalet: “Më të nderuarën...” dhe **Zbritësorja IX**.

“I shenjtë është Zoti...” – “Lartësoni Zotin...”.

DËRGIMSORJA ngjallësore III, e shenjtorit: “Si biri i gjëmonjësit...” dhe Hyjlindësorja e saj: “Nga Kryqi Shpëtimtari Krisht...”.

LAVDËRIMET: psalen 4 Vargëzimet ngjallësore dhe 3 Vargëzimet e përshembullta të shenjtorit, të cilat bëhen 4. “Lavdi...”, e shenjtit: “O ungjillor shën Joan...”. “Tani...”, “E përmbibekuar je...”.

DHOKSOLOGJIA e Madhe, “Sot erdhi shpëtimi...”.

Në Liturgji:

ANDIFONET e së dielës.

Pas HYRJES psalet Përlëshorja ngjallësore: “Fjalën e panisëshme...”, e shenjtit: “O Apostull i dashur i Krishtit...” dhe e shenjtit të kishës. Shkurtorja: “Mbrojtje e paturpëruar...”.

APOSTULLI i ungjillorit (26 shtator – 1 Jn. 4:12-19).

UNGJILLI i ungjillorit (26 shtator – Jn. 19:25-27, 21:24-25).

Te “VEÇAN TË TËRËSHENJTËN...”, psalet: “Të meriton...”.

KUNGATORJA e së dielës: “Lavdëroni Zotin...”.

“PAMË DRITËN...” dhe pjesa e mbetur e Liturgjisë.

27. E hënë. Apostujt Aristarku, Zinoni, Marku nga të 70-t. Dëshmor Kalistrati. Dëshmore Epihairsa. Dëshmore e re Akilina.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së hënës së javës së 15-të të Letrave (Gal. 2:11-16).

UNGJILLI i së hënës së javës së 2-të të Llukait (Llk. 4:38-44).

28. E martë. Profeti Varuk. Hariton Omologjeti (Pohuesi). Alkisoni i Nikopojës. Viaçeslavi në Çeki.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së martës së javës së 15-të të Letrave (Gal. 2:21-3:7).

UNGJILLI i së martës së javës së 2-të të Llukait (Llk. 5:12-16).

29. E mërkurë. Oshënar Qirjako. Dëshmorët Petronia, Dadi, Kasdoa, Kasdou, Govdeli, Godbdalahai.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së mërkurës së javës së 15-të të Letrave (Gal. 3:16-22).

UNGJILLI i së mërkurës së javës së 2-të të Llukait (Llk. 5:33-39).

30. E enjte. Hierodëshmor Grigori, ndriçues i Armenisë. Dëshmor Mardoni. Dëshmore Gajana.

Mbrëmësorja e përditshme.

Mëngjesorja e përditshme.

APOSTULLI i së enjtes së javës së 15-të të Letrave (Gal. 3:23-4:5).

UNGJILLI i së enjtes së javës së 2-të të Llukait (Llk. 6:12-19).